



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE**  
**BORDI**

**VENDIM**

**Nr. 41, datë 26.02.2018**

**PËR**  
**MIRATIMIN E KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES TË SHOQËRISË AUDITUESE,**  
**PËR AUDITIMIN E PASQYRAVE FINANCIARE TË AUTORITETIT TË**  
**MBIKËQYRJES FINANCIARE, PËR VITIN 2017**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 16, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, si dhe të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

**V E N D O S I:**

1. Miratimin e kriterëve të përzgjedhjes të shoqërisë audituese, për auditimin e pasqyrave financiare për vitin 2017, të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, sipas materialit bashkëlidhur.
2. Ngarkohet Drejtorja e Shërbimeve Mbështetëse për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR**  
**Pajtim MELANI**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV**  
**Ervin KOÇI**

**I Kriteret e përzgjedhjes të shoqërisë audituese (*person juridik*) nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare:**

- a. Të jetë i licencuar apo i regjistruar në regjistrin publik si Auditues Ligjor për ushtrimin e kësaj veprimtarie në Republikën e Shqipërisë;
- b. Të ketë 5 (pesë) vjet eksperiencë në fushën e auditimit ligjor të pasqyrave financiare të bankave ose subjekteve të tjerë financiare dhe autoritete rregullatore financiare që mbajnë kontabilitetin sipas Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF-ve);
- c. Të paktën dy prej ortakëve ose të punësuarve të shoqërisë të kenë titull profesional “Auditues Ligjor”;
- d. Të mos ketë konflikt interesash me subjektin që auditon, sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”;
- e. Të mos jetë subjekt i masave disiplinore në fuqi, të vendosura nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike në momentin e aplikimit;
- f. Të ketë fituar titullin ACCA të paktën njëri nga ortakët.